



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 124, datë 29.06.2023

**PËR MIRATIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË DREJTORËVE
TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE
GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21, pika 1, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe të rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikqyrës, Administratorit/anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Klaidi Çitozi, si Drejtor i Përgjithshëm dhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit “Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare.**
- 2. Miratimin e riemërimit të z. Ervin Rali dhe z. Artan Pjetërnikaj, si anëtarë të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit “Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE